

# ANONIZIMI I VENDIMEVE GJYQËSORE



Autor: Eranda Zekaj

Redaktor: Gzim Shala

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

*Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Institutit të Kosovës për Drejtësi - IKD dhe ajo nuk pasqyron pikëpamjet e Byrosë për Çështje të Narkotikëve Ndërkombëtarë dhe Zbatimit të Ligjit (INL) - Departamenti i Shtetit Amerikan dhe NED-it.*

## RRETH IKD

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

## IKD

Rr. Ilaz Agushi  
Prishtinë  
E: [info@kli-ks.org](mailto:info@kli-ks.org)  
[www.kli-ks.org](http://www.kli-ks.org)

Janar, 2023  
Prishtinë, Republika e Kosovës

Përkrahur nga:



**National Endowment  
for Democracy**

*Supporting freedom around the world*

## Përmbajtja

1.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE .....	4
2.	PRAKTIKAT MBI (MOS) ANONIMIZIMIN E VENDIMEVE GJYQËSORE.....	5
3.	QËLLIMET KRYESORE PËR MOSPUBLIKIMIN E PA ANONIMIZUAR TË VENDIMEVE GJYQËSORE.....	7
3.1.	Implikimet në qëllimin e sanksionit penal .....	7
3.2.	Rëndësia e institutit të rehabilitimit .....	7
3.3.	Cënimi i të drejtës për t’u harruar .....	8
3.4.	Publikimi i aktgjykimit si dënim plotësues.....	9
3.5.	Kufizimi i të drejtave dhe lirive Themelore.....	9

## 1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Publikimi i emrave të palëve në vendimet e gjykatave është një çështje komplekse që shtron dilema në lidhje me ekuilibrin midis mbrojtjes së të dhënave personale dhe privatësisë në njërin anë, si dhe sigurimit të transparencës dhe qasjes së publikut në vendimet e gjykatave në anën tjetër.

Ligji Nr.06/L-054 për Gjykatat [neni 6.3.] ka përcaktuar obligimin e publikimit të aktgjykimeve, sipas legjislacionit në fuqi. Në përputhje me këtë obligim dhe Ligjin Nr.06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka nxjerrë Udhëzimin Administrativ Nr.04/2019 për Publikimin e Aktgjykimeve të Përpunuara. Në përputhje me këtë udhëzim, gjykatat në Kosovë i anonimizojnë e më pastaj publikojnë aktgjykimet.

Sa i përket publikimit të aktgjykimeve, fillimisht duhet theksuar faktin se në shtetet anëtare të Bashkimit Evropian, nuk ka një qasje uniforme mbi praktikën që duhet ndjekur me rastin e publikimit të aktgjykimeve, përkatësisht nëse ato duhet të publikohen të anonimizuar ose pa anonimizuar. Disa gjykata i anonimizojnë të gjitha vendimet gjyqësore, të tjera vetëm me kërkesë të palëve ose me vendim të veçantë të gjyqtarit.

Por, në rastin e Kosovës, IKD gjen se publikimi i pa anonimizuar i vendimeve gjyqësore nuk gjenë vend në rendin kushtetues dhe juridik të Kosovës. Me këtë rast, kufizimi i të drejtës në privatësi në favor të transparencës do të ishte jo proporcional. Kjo pasi publikimi i pa anonimizuar i aktgjykimeve do të kishte pasoja në qëllimin e dënimit si dhe do ia humbte kuptimin edhe rehabilitimit ligjor/gjyqësor të dënimit. Po ashtu, publikimi i aktgjykimeve me përmbajtjen e emrave të pjesëmarrësve në procedurë do të humbas gjithashtu kuptimin e urdhrin për publikimin e aktgjykimit, i cili urdhrë shqiptohet nga gjykatat në rastet kur konsiderohet se dënimi kryesor nuk është i mjaftueshëm për tu arritur qëllimi i dënimit.

Publikimi i pa anonimizuar i të gjitha vendimeve gjyqësore paraqet shkelje të së drejtës për tu harruar. Kjo pasi kjo formë e publikimit të vendimeve gjyqësore pa vlerësim paraprak të gjyqtarit, pamundëson gjykatën për të vlerësuar kriteret që, në kuptim të së drejtës për tu harruar, duhet të respektohen para dhe pas publikimit. Nisur nga fakti se kjo e drejtë është brenda korpusit të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, publikimi i paanonimizuar i vendimeve gjyqësore, në kuptim të nenit 22 dhe 53 të Kushtetutës, konsiderohet kundër kushtetuese.

Në anën tjetër, përderisa të dhënat personale janë të mbrojtura me Kushtetutë, publikimi i pa anonimizuar i vendimeve gjyqësore paraqet kufizim të lirive dhe të drejtave të njeriut. Në këtë drejtim, IKD gjenë se një masë e tillë nuk do të kalonte testin sipas kriterëve që kërkohen me rastin e kufizimit të të drejtave të njeriut, të cilat kritere janë të përcaktuara në nenin 55 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Për këtë arsye, IKD vlerëson se vendimet gjyqësore duhet të vazhdojnë të publikohen të anonimizuar.

*Kjo analizë publikohet nga IKD në Javën për Mbrojtjen e të Dhënave Personale – 2023.*

## 2. PRAKTIKAT MBI (MOS) ANONIMIZIMIN E VENDIMEVE GJYQËSORE

Si rregull i përgjithshëm, emrat e palëve dhe zakonisht emrat e pjesëmarrësve tjerë, duhet të zëvendësohen me inicialet e tyre ose me inicialet fiktive, emri fiktiv, përdorimi i termave si 'kërkuesi', përdorimi i pseudonimit, megjithatë ka disa praktika juridike që shmangin këtë parim.<sup>1</sup> Një çështje e tillë trajtohet ndryshe në Shtetet Anëtare të BE-së, në Gjykatën e Drejtësisë së Bashkimit Evropian dhe në Gjykatën Evropiane të Drejtave të Njeriut.

Në Gjykatën e Drejtësisë së Bashkimit Evropian dhe Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si rregull i përgjithshëm, informacioni për palët ose palët e treta është i qasshëm për publikun. Përfundimisht nga ky rregull janë rastet e jashtëzakonshme, të cilat lidhen me anonimitetin e procedurave gjyqësore. Prandaj, në raste të jashtëzakonshme dhe të justifikuar siç duhet, këto gjykata autorizojnë anonimitetin.<sup>2</sup>

Megjithatë, për të garantuar mbrotje të të dhënave të personave fizikë, Gjykata e Drejtësisë ka vendosur që për të gjitha kërkesat për vendime paraprake të paraqitura pas datës 1 korrik 2018, të zëvendësojë emrat e personave fizikë të përfshirë në çështje me inicialet në të gjitha dokumentet e saj publike. Në mënyrë të ngjashme, çdo element shtesë që mund të lejojë identifikimin e personave në fjalë do të hiqet.<sup>3</sup>

Gjykatat e Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian kanë qasje të ndryshme në lidhje me anonimizimin e vendimeve gjyqësore. Disa gjykata i anonimizojnë të gjitha vendimet gjyqësore, të tjera vetëm me kërkesë të palëve ose me vendim të veçantë të gjyqtarit. Kështu, nuk ka një qasje uniforme që ndiqet në këtë drejtim. Në disa vende anonimizimi i vendimeve është rregull dhe në disa vende tjera është përjashtim. Në Raportin për qasje në të dhëna gjyqësore konstatohet se në 15 vende të ndryshme ka dallime të theksuara sa i përket rregullimit ligjor për publikimin dhe anonimizimin e vendimeve gjyqësore.<sup>4</sup>

Në vitin 2005 Këshilli i Bashkimit Evropian<sup>5</sup> shpall një analizë të detajuar për rregullimin ligjor mbi anonimizimin e vendimeve gjyqësore në 15 vendet anëtare. Sipas të dhënave të raportit, anonimizimi i vendimeve është rregull në njëmbëdhjetë nga pesëmbëdhjetë shtetet anëtare. Prej nga rrjedhë se anonimizimi i vendimeve bëhet në mënyrë automatike dhe nuk ka

---

<sup>1</sup> Research Note, "Anonymity of the parties on the publication of the court decisions.", 2017, F.5-6.

<sup>2</sup> Edita Gruodytė and Saulė Milėiuvienė. "Anonymization of court decisions: are restrictions on the right to information in" accordance with the law"?. Baltic journal of law & politics 9.2, 2016, f.162-163.

<sup>3</sup> "From 1 July 2018, requests for preliminary rulings involving natural persons will be anonymised" Court of Justice of the European Union, June 2018. (Shih linkun <https://curia.europa.eu/jcms/upload/docs/application/pdf/2018-06/cp180096en.pdf>). (Qasur për herë të fundit më 23 janar 2023).

<sup>4</sup> "Report on Access to Judicial Information. Open society," Justice initiatives, March 2009, (Shih linkun <http://www.right2info.org/resources/publications/publications/Access%20to%20Judicial%20Information%20Report%20R-G%203.09.DOC>). (Qasur për herë të fundit më 23 janar 2023).

<sup>5</sup> Council of the European Union, "Summary on a question-by-question basis from the answers given by the Member States to the questionnaire on case law", 2005, (Shih linkun <http://register.consilium.europa.eu/doc/srv?l=EN&f=ST%2014577%202005%20INIT>). (Qasur për herë të fundit më 23 janar 2023).

nevojë që për një gjë të tillë të parashtrihen kërkesa të veçanta, ndërsa në katër shtete tjera anonimizimi i vendimeve gjyqësore është një përjashtim dhe nevojiten kërkesa të veçanta.<sup>6</sup>

Liria e shprehjes dhe qasjes, si të drejta të garantuara si me legjislacionin e brendshëm ashtu dhe me atë ndërkombëtarë, duhet të përmbushen deri në atë masë që nuk cenohet e drejta e privatësisë.<sup>7</sup> Duke pas parasysh që mbrotja e të dhënave personale paraqitet si e drejtë e veçantë e privatësisë, Rregullorja e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave të Bashkimit Evropian, synon kryesisht gjetjen e ekuilibrit në mes të këtyre të drejtave dhe njëkohësisht të unifikojë definicionin e të dhënave personale për të gjithë shtetet e BE-së. Përveç qëllimit kryesor në mbrojtjen e së drejtës së privatësisë në përgjithësi dhe mbrotjës së të dhënave personale në veçanti, kjo Rregullore ka definuar edhe kuptimin e të dhënave personale të përcaktuar në nenin 4 "*cto informacion në lidhje me një person fizik të identifikuar ose të identifikueshëm ("subjekt i të dhënave"); një person fizik i identifikueshëm është ai që mund të identifikohet, drejtpërdrejt ose tërthorazi, veçanërisht duke iu referuar një identifikuesi si emri, një numër identifikimi, të dhënat e vendndodhjes...*".

Në këtë drejtim, Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale i miratuar më 25 shkurt 2019 përgjithësisht është hartuar në përputhshmëri me dispozitat e Rregullorës së lartpërmendur, duke përfshirë edhe përkufizimin e njejtë të të dhënave personale.

Kështu, sipas këtij përkufizimi, emrat në vendime gjyqësore bien në sferën e të dhënave personale, të cilat kërkojnë mbrojtje.

---

6 Gruodytė, Edita, and Saulė Milėiuviėnė. "Anonymization of court decisions: are restrictions on the right to information in" accordance with the law"?.*"* Baltic journal of law & politics 9.2, 2016, f. 150-170.

7 Von Hannover kundër Gjermanisë, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, June 2004 par. 57-58; Axel Springer Ag kundër Gjermanisë, 2012, par. 84 dhe 89.

### **3. QËLLIMET KRYESORE PËR MOSPUBLIKIMIN E PA ANONIMIZUAR TË VENDIMEVE GJYQËSORE**

#### **3.1. Implikimet në qëllimin e sanksionit penal**

Kodi Penal dhe Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale kanë përcaktuar rregullat që kanë të bëjnë me qëllimin e dënimit. Kështu, secila masë që mund të ketë ndonjë ndikim në qëllimin e dënimit, duhet të balancohet me këtë qëllim.

Përderisa qëllimi kryesor i ekzekutimit të sanksioneve penale nuk është vetëm përgjegjësia e kryerësve të veprave penale por edhe risocializimi dhe riedukimi i të dënuarve, që të njëjtit të jenë kontribues të shoqërisë, etiketimi i këtij numri të njerëzve dhe privimi i tyre i përhershëm nga shoqëria<sup>8</sup> (kjo exlege, pa vlerësim të gjykatës) përmes publikimit të aktgjykimeve nuk i shërben qëllimit të sanksionit penal. Me kalimin e kohës, individët duhet të kenë mundësinë të rindërtojnë jetën e tyre pa u përballur me gabimet e tyre të së kaluarës nga anëtarët e publikut.<sup>9</sup>

Ligji ka paraparë edhe obligimin e institucioneve për ndihmë të personave të cilët tanimë kanë vuajtur dënimin.<sup>10</sup> Etiketimi i qytetarëve të cilët janë dënuar nga gjykata, u shkakton të njëjtëve sfidë për tu riintegruar në shoqëri, në kuptim të punësimit të tyre dhe zhvillimit normal të jetës. Kështu publikimi i emrit të personave që kanë problem me ligjin cilësohet si pengesë në riintegrimin e tyre. Kështu, në të ardhmen pikërisht publikimi i aktgjykimit mund të ketë kundër efekt në qëllimin e dënimit.

#### **3.2. Rëndësia e institutit të rehabilitimit**

Sipas Kodit Nr.06/L-074 Penal, “[p]asojat juridike të dënimit nuk krijohen kur kryesit i shqiptohet gjoba apo vërejtja gjyqësore”.<sup>11</sup> Në anën tjetër, edhe për dënimet ku ligji parasheh pasoja juridike, ato nuk janë të përhershme. Karakterin e përhershëm të këtyre pasojave, në drejtim të arritjes së qëllimit të dënimit, e parandalon instituti i rehabilitimit.

Instituti i rehabilitimit mundëson mbrojtjen e të drejtave të të dënuarve, të cilat nuk duhet kufizuar vetëm me faktin se një person ka qenë i dënuar. Në këtë mënyrë, pas vuajtjes së dënimit, personi i dënuar do të konsiderohet i pa dënuar dhe do i kthehen të gjitha të drejtat që i ka pasur para se të jetë dënuar. Por a do të trajtohet një i dënuar në mënyrë të barabartë me personat tjerë, nëse pas mbajtjes së dënimit emri i tij për kryerjen e veprës përkatëse është i publikuar?

Për arsyet si më lartë, në rendin juridik kosovar, publikimi eventual i aktgjykimeve me emrat e të dënuarve, nuk gjenë sinkronizim me rregullat e tjera të drejtësisë penale. Si rrjedhojë, kjo masë e veçantë minon zbatimin adekuat të rregullave të tjera bazike.

---

<sup>8</sup> Leonora Shemsiu-Kadriu, “Rehabilitimi dhe zbulimi i të dhënave nga dosja penale”, f.23.

<sup>9</sup> *Mutatis mutandis*, *Österreichischer Rundfunk kundër Austrisë*, 2006, par.68.

<sup>10</sup> Ligji Nr. 08/L-132 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 129.

<sup>11</sup> KODI NR. 06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës, neni 93.2.

### 3.3.Cënimi i të drejtës për t'u harruar

E drejta për t'u harruar i takon një individ të dhënat e të cilit gjenden në internet, i cili është i pakënaqur me ekzistimin e atyre të dhënave dhe dëshiron t'i largojë nga arkivat në ueb. E drejta për t'u harruar nuk është absolute, por e njejta çdoherë duhet balancuar me të drejtën për liri të shprehjes dhe informimit, përkatësisht balancim i nenit 8 dhe 10 të KEDNJ. Rezultati i këtij balancimi varet nga rrethanat e rastit konkret<sup>12</sup>. Kjo e drejtë njihet edhe në Ligjin Nr.06/L-082 [neni 16] për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Përderisa, edhe pse e ndërvaruar, tanimë ekziston edhe e drejta për tu harruar, masa e publikimit të aktgjykimeve me emra duhet të balancohet edhe me këtë të drejtë. Prandaj është e rëndësishme që para publikimit të vendimeve gjyqësore, t'i kushtohet rëndësi kritereve të identifikuar nga GJEDNJ, në kontekstin e balancimit të së drejtës për lirinë e shprehjes dhe të drejtës për respektimin e jetës private. Kur kemi të bëjmë me publikimin e të dhënave të caktuara për persona të ndryshëm, në mënyrë që të respektohet e drejta për tu harruar, duhet të respektohet disa kritere të përgjithshme për të përcaktuar nëse në një rast të caktuar duhet ose jo të publikohen të dhëna të caktuara për persona të ndryshëm. Në këtë drejtim, si kritere të përgjithshme<sup>13</sup>, por të varura nga rasti konkret<sup>14</sup> janë: 1) kontributi në interesin publik, 2) nëse personi në fjalë është i njohur për publikun, 3) sjellja e mëparshme e personit në fjalë 4) mënyra e marrjes së informacionit dhe 5) vërtetësia, përmbajtja, forma dhe pasojat e publikimit dhe ashpërsia e masës së shqiptuar.

Gjersa mediat duhet të ndjekin në praktikë këto kritere për raportim me emra, mos ndjekja e këtyre kritereve nga gjykatat të cilat duhet të mbrojnë zbatimin e këyre kritereve, nuk ka kuptim. Kështu, përcaktimi i rregullës për publikimin e aktgjykimeve të paanonimizuar do të sjellte një situatë paradoksale ku për respektimin e së drejtës për tu harruar do të duhej të kujdeseshin mediat, por jo edhe vet gjykatat, që duhet të mbajnë përgjegjësinë mediat për respektimin e kësaj të drejte.

Ndërtimi i rregullave të përgjithshme për publikim të aktgjykimeve të paanonimizuar, pa vlerësim paraprak të gjyqtarit të cilit i mundësohet ta bëjë këtë, pamundëson gjykatën për të vlerësuar këto kritere. Kështu, krahas të tjerave, kjo rregull do të ishte në kundërshtim edhe me të drejtën për tu harruar. Nisur nga fakti se kjo e drejtë është brenda korpusit të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, publikimi i paanonimizuar i vendimeve gjyqësore, në kuptim të nenit 22 dhe 53 të Kushtetutës, konsiderohet kundër kushtetuese.

---

<sup>12</sup> Shih për më shumë: Meg Leta Jones, “Ctrl + Z: The Right to Be Forgotten”, NYU Press, 2008.

<sup>13</sup> Von Hannover kundër Gjermanisë, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, June 2004 par.60.

<sup>14</sup> Axel Springer Ag kundër Gjermanisë, 2012, par. 89.



### 3.4. Publikimi i aktgjykimit si dënimi plotësues

“Gjykata mund të urdhërojë publikimin e aktgjykimit kur çmon se publikimi është në interes të përgjithshëm, të të dëmtuarit ose të personave të tjerë” thuhet në Kodin Penal<sup>15</sup>. Publikimi i aktgjykimeve me përmbajtjen e emrave të pjesëmarrësve në procedurë do të humbas gjithashtu kuptimin e këtij dënimi plotësues.

Duhet theksuar se dënimi plotësues i publikimit të aktgjykimit nuk urdhërohet nëse publikimi i tillë e rrezikon fshehtësinë zyrtare, privatësinë e personave apo moralin e shoqërisë<sup>16</sup> dhe jetën personale të personit të mitur, ngase kjo do ta bënte të pamundur apo do ta vështirësonte së tepërmi zhvillimin dhe risocializimin dhe integrimin e tyre në shoqëri.<sup>17</sup> Pra, edhe në të drejtën e gjyqararit për ta bërë këtë, ka kufizime. Si rrjedhojë, përcaktimi i rregullave të përgjithshme për publikimin e pa anonimizuar të aktgjykimeve ia humb kuptimin urdhrorit për publikimin e aktgjykimit, i cili urdhër shqiptohet nga gjyqtari në përputhje me vlerësimet e tij sipas rrethanave të secilit rast konkret.

### 3.5. Kufizimi i të drejtave dhe lirive Themelore

Siç u tha në fillim të këtij dokumenti, publikimi i pa anonimizuar i aktgjykimeve përbën ndërhyrje apo kufizim të së drejtës së privatësisë, e drejtë kjo e garantuar me Kushtetutë [neni 31] dhe KEDNJ [neni 8]. Kështu, publikimi i pa anonimizuar i aktgjykimeve mund të bëhet vetëm në përputhje me rregullat që duhet ndjekur me rastin e kufizimit të të drejtave të njeriut.

Fillimisht, duhet theksuar se KEDNJ [neni 8.2] ka përcaktuar rregullat se kur lejohet kufizimi i kësaj të drejte, e që janë: 1) Kufizimi duhet të jetë i parashikuar me ligj, 2) ndërhyrja duhet të jetë e nevojshme në një shoqëri demokratike, 3) të jetë në interes të sigurisë publike, mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit apo mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve. Në raport me këto rregulla, eventualisht, si bazë e mjaftueshme për përcaktimin me ligj të publikimit të pa anonimizuar të aktgjykimeve do të mund të konsiderohet mbrojtja e të drejtave të palëve të dëmtuara.

Por, krahas rregullave të KEDNJ, Kushtetua e Republikës së Kosovës [neni 55] ka përcaktuar rregulla më të detajuara që duhet respektuar me rastin e kufizimit të të drejtave të njeriut<sup>18</sup>, e që përfshijnë: 1) Kufizimi duhet të parashihet me ligj, 2) Kufizimi duhet të jetë vetëm deri në masën që konsiderohet i domosdoshëm në një shoqëri të hapur dhe demokratike, për të arritur qëllimin për të cilin lejohet kufizimi, 3) Ti kushtohet kujdes esencës së të drejtës që kufizohet, rëndësisë së qëllimit të kufizimit, natyrës dhe vëllimit të kufizimit, raportit midis kufizimit dhe

---

<sup>15</sup> KODI NR. 06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës, neni 66.

<sup>16</sup> Po aty, neni 66.5.

<sup>17</sup> Prof. Dr. Ismet Salihu, Mr.Sc. Hilmi Zhitija, Dr.Sc. Fejzullah Hasani, “Komentari i Kodit Penal të Republikës së Kosovës”, 2014, f.252.

<sup>18</sup> Shënim: Përderisa KEDNJ konsiderohet dokument që përcakton të drejtat minimale, legjislacioni vendor ka përparësi ndaj saj në rastet kur garanton të drejta më të gjera: Alessia Cozzi, Athanassia Sykiotou, Dagmara Rajska, Ivana Krstic, Maria Filatova, Nikolina Katic, Petra Bard, Stephanie Bourgeois, "COMPARATIVE STUDY on the Implementation of the ECHR at the National Level", Council of Europe, 2016, f.26.

qëllimit që synohet të arrihet dhe 4) Të shqyrtohet mundësia e realizimit të qëllimit me kufizim më të vogël.

Kështu, krahas bazës që paraqet lejueshmërinë e kufizimit të të drejtave, në secilin rast kur synohet të kufizohen të drejtat e njeriut, duhet të shqyrtohen këto kritere të përcaktuara në nenin 55 të Kushtetutës. Me këtë rast, duhet theksuar se synimi eventual për ndërtimin e rregullave për publikimin e të gjitha aktgjykimeve, nuk ka një synim specifik që synohet të arrihet dhe vetëm përgjithësisht do të mund të pretendohej mbrojtja e të drejtave të viktimave. Sa i përket vëllimit të kufizimit, ndërtimi i rregullave për publikimin e paanonimizuar të të gjitha vendimeve gjyqësore në praktikë do të reflektohej me publikimin e paanonimizuar edhe të aktgjykimeve në rastet kur fare nuk ka palë të dëmtuara. Kështu, dispozitat eventuale për publikimin e paanonimizuar të të gjitha vendimeve gjyqësore nuk e kalojnë as këtë kriter kushtetues.

Tutje, sipas kushtetutës, në secilin rast të kufizimit të të drejtave, duhet të shqyrtohet edhe mundësia e arritjes së qëllimit të synuar përmes masave më të buta. Në të gjitha rastet kur publikimi i aktgjyktimit është i nevojshëm për sforcimin e efektit të dënimeve kryesore, gjykata mund të shqiptojë dënimin plotësues – urdhërin për publikim të aktgjykimeve. Në këtë drejtim, mungesa e shqiptimit të dënimeve të tilla nga gjykatat, përkundër mundësisë ligjore, nuk mund të përdoret si arsye për hapjen automatike të të gjithë emrave të përfshirë në vendime gjyqësore. Kështu, në këtë situatë, kërkohet angazhim për zbatim të kësaj mundësie ligjore dhe jo që kësaj mundësie ligjore ti humbet kuptimi. Në këtë drejtim, Gjykata Supreme mund të nxjerr një mendim juridik lidhur me dënimet plotësuese, përkatësisht konkretizimit të rasteve kur ky dënim mund të shqiptohet. Kështu, urdhëri për publikim të aktgjykimit mundëson përzgjedhjen e personave për të cilët publikimi i aktgjykimit ka efekt duke përjashtuar kështu personat e tjerë për të cilët dënimi kryesor është mjaftueshëm efektiv.